

## NGA ZHGËNJIMI I MADH TE BESIMI I PLOTË

Napoleon Bonaparti burgosi një burrë të quajtur Charney. Një lule e vogël sapo kishte filluar të lulëzonte brenda oborrit të burgut. Në një mur, që ndodhej afër kësaj luleje, ishte shkruar: «Gjithçka ndodh aksidentalisht.» Kjo frazë shpesh përdoret për të shpjeguar shkurtimisht Revolucionin Francez. Çdo ditë kjo lule i mësonte Charney-t, që ecte i vetmuar në oborrin e burgut, mësimin për besimin. Ai e lidhi lulen rreth një shkopi për ta mbajtur drejt dhe vendosi një kompesatë rrotull saj për ta mbrojtur. Ai nuk besonte në thënien se gjithçka ndodh aksidentalisht. «Por», mendoi ai, «ekziston një Qenie i cili e krijoi me mjeshtëri këtë lule kaq të bukur dhe e mban atë me jetë». Ai i fshiu fjalët e pavërteta nga muri; në zemrën e tij ai besoi: «Ai që ka krijuar gjithçka është Perëndia.» Perandoresha Josefinë dëgjoi për dashurinë që Charney kishte për lulen dhe u interesua për çështjen e tij. Ajo mendoi: «Një njeri që e do një lule dhe kujdeset për të nuk mund të jetë një njeri i keq.» Ajo e bindi perandorin që ta lirojë Charney-n. Charney e mori lulen e vogël në shtëpi dhe me shumë vëmendje kujdesej për të në serën e tij. Kjo lule i mësoi atij që t'i besonte Perëndisë dhe gjithashtu e liroi atë nga burgu! Charney është një shembull i mrekullueshëm se si «zhgënjimi dhe humbja e plotë» e ateizmit mund të kthehet në «fitim të madh» për besimin!

Një ilustrim tjetër i këtij ndryshimi gjendet te 2 Mbretërve 5. Jeta e Naamanit është historia e një ateisti i cili jetën plot humbje e zhgënjim e ktheu në

fitore të madhe përmes besimit. Lexoni për kthimin e tij nga ateizmi te besimi te 2 Mbretërve 5:15–17:

Pastaj u kthye me gjithë suitën e tij te njeriu i Perëndisë, shkoi e u paraqit para tij dhe tha: «Tani e pranoj që nuk ka asnjë Perëndi, në gjithë dheun, përveç se në Izrael. Prandaj tani prano një dhuratë, të lutem, nga shërbëtori yt.» Por ai u përgjigj: «Ashtu siç është e vërtetë që rron Zoti, në prani të të cilit ndodhem, nuk kam për të pranuar asgjë.» Naamani ngulte këmbë që të pranonte, por ai refuzonte. Atëherë Naamani tha: «Me qenë se ti nuk do, lejo që t'i jepet shërbëtorit tënd aq tokë sa mund të mbajnë dy mushka, sepse shërbëtori yt nuk do t'u ofrojë më olokauste as flijime perëndive të tjera, por vetëm Perëndisë.»

Çdo njeri që e kërkon me ndershmëri të Vërtetën ballafaqohet gjithnjë me pyetjen e ekzistencës së Perëndisë. Ne nuk mund ta marrim jetën aq lehtë sa ta anashkalojmë këtë pyetje të rëndësishme. Ekzistenca e Perëndisë influencon drejtpërdrejt jetën tonë të përditshme. Njeriu i sotëm ballafaqohet me dy alternativa për Perëndinë, të besojë apo të mos besojë në Të (të besojë në ateizmin). Çdo alternativë duhet parë me vëmendje, asgjë nuk duhet anashkaluar. Integriteti është pikënisja e çdo kërkimi. Në mësimet e mëparshme të këtij studimi, kemi studjuar alternativën që ofron ateizmi dhe kemi parë se është një filozofi që s'mund të mbrohet me argumente. Ateizmi ka ngritur një sistem besimi që bazohet në paragjykimin dhe inatin. Është e qartë se filozofia ateiste, si ka shkruar Ravi Zacharias, për të qenë e pranueshme duhet «të shpjegojë se si gjërat u krijuan

aksidentalisht, të kritikojë si imorale gjithë akuzat e saj, të shpjegojë në mënyrë të kuptueshme gjithë pakuptueshmërinë e saj dhe të gjejë siguri aty ku nuk ka shpresë. Kjo duket pak e ngatërruar, madje edhe për një magjistar fjalësh.» Ky përshkrim i ateizmit bën çdo njeri të ndershëm ta mohojë atë si një zgjidhje të pranueshme për jetën. Dhe pasi filozofia ateiste hidhet poshtë, vetëm besimi në Perëndi mbetet si filozofia e jetës. Ky është përfundimi në të cilin Charney, Naaman dhe shumë të tjerë kanë arritur. Dhe ata janë në rrugë të drejtë, sepse besimi në Perëndi është i vetmi përfundim i *arsyeshëm* që mund të arrihet!

Me këto mendime në mendje, shiko se si një njeri që me ndershmëri kërkon të Vërtetën do të kthehet nga humbja dhe zhgënjimi i plotë i ateizmit te shpërblimet e shumta të besimit që burojnë nga Perëndia!

### **NJË RISHIKIM I PARIMEVE KRYESORE TË ATEIZMIT**

Ne e kemi parë se si ateizmi i heq jetës kuptimin, qëllimin dhe vlerën. Për t' i mbajtur mend më mirë, le të shikojmë përsëri pasojat e ateizmit.

*E para, ateizmi dizinformon njerëzit rreth origjinës së tokës dhe njeriut.* Sipas filozofisë ateiste, besimi te Perëndia ka mbetur nga e kaluara e errët dhe primitive. Kjo filozofi sugjeron se çdo teori që thotë se Perëndia e krijoi njeriun është absurde. Sipas filozofisë ateiste, njeriu rrjedh nga materia pa jetë. Sipas tyre, gjithë jeta bëhet materie e «vdekur» në lëvizje! E njëjtë me këtë sugjerim është teoria se gjithë jeta filloi në «baltë». Gjithë strukturat me jetë, madje edhe ato më të komplikuarat, në mënyrë sistematike u krijuan nga proceset natyrore! Ky koncept i origjinës nuk është i justifikueshëm. Shkenca deklaron se gjithçka (madje edhe materia pa jetë) ka pasur një pikë fillimi! Asnjë provë nuk ekziston për të vërtetuar konceptin e evolucionit, i cili konsiderohet si gurë themeli për ateizmin.

*E dyta, ateizmi i shkakton një dëm të madh moralitetit.* Sipas ateizmit, njeriu është krijesë e formuar nga instinkti dhe impulsi. Ai është një kafshë e një rangu më të lartë që ka të drejtën e zgjedhjes, por që, sidoqoftë mbetet një kafshë. Në këtë mënyrë ateizmi mbron moralin e vërtetë dhe absolut. Ateizmi mbron pretendimet se e drejta dhe e gabuara janë çështje relative që duhen ndryshuar dhe përshtatur sipas interesit të çdo brezi. Ateizmi

i ofron njeriut një jetë të pamoralshme. Besimi në teorinë ateiste shkakton humbje të madhe dhe sjell dëshpërim që vetëm kafshët e provojnë. Dëshirat për kënaqësi të menjëhershme që vijnë nga instinkti dhe impulsi hapin gropa që mbajnë papastërti të vazhdueshme. Kafshët nuk kanë të drejtën e zgjedhjes. Për to gropa është e vetmja alternativë dhe natyrisht papastërtitë e tyre shtohen vazhdimisht. Sidoqoftë, njerëzit, ndryshe nga kafshët, kanë mundësinë që të marrin vendime të moralshme që krijojnë përgjegjësi, për të cilat Bibla shpjegon pasojat e përjetshme.

*E treta, ateizmi plotësisht i heq kuptimin jetës.* Ateizmi nuk është në gjendje të formulojë ndonjë qëllim për jetën. Ne jemi këtu në tokë aksidentalisht, ne jetojmë me anë të instinktit dhe kur vdesim shkatërrohemi një herë e përgjithmonë! Çfarë filozofie e zymtë! Meqenëse kjo filozofi nuk përmban ndonjë qëllim shpirtëror, njeriu ushqehet nga «pislleqet» e dëshirave të trupit dhe përfundon në «gropën» e dëshpërimit. Ateizmi, duke mohuar qëllimin dhe kuptimin e jetës, i ka udhëhequr njerëzit në një jetë me dëshpërim të pafund.

*E katërta, ateizmi shkakton një humbje të plotë të shpresës.* Edhe pse ateizmi teorizon se evolucionin në fund do të sjellë lumturinë dhe mirësinë, ai nuk e realizon dot këtë. Qëllimi i ateizmit është shumë larg realitetit të jetës. Njeriu pa Perëndinë nuk është në gjendje të ushtrojë «mirësinë» (të jetë i mirë në mënyrë të vazhdueshme). Mendjet e zgjuara njerëzore mund të shpikin makinat inxhinierike më komplekse, por të njëjtat mendje nuk janë në gjendje të krijojnë në tokë një jetë shpresëdhënëse pa Perëndinë! Vetë ndjekësit e ateizmit e kanë të qartë humbjen e shpresës. Shiko boshllëkun e krijuar nga mungesa e shpresës të shprehur nga George Gordon, ose siç e quajmë ndryshe Lordi Bajron, te *Shtegtimi i Çajld Haroldit*:

I vetëarratisuri Harold shkon poshtë e përpjetë,  
Me shumë dëshpërim dhe aspak shpresë për veten;  
Fakti që ai e dinte se e kishte shkuar jetën më kot,  
Që gjithçka kishte mbaruar në këtë anë të varrit,  
E kishte bërë dëshpërimin një mendim të pranueshëm,...

Meqenëse ateizmi nuk e përmban shpresën në mësimet e tij, ai ka si qëllim ta shkatërrojë një shpresë të tillë për gjithë njerëzimin. Sot influenca e ateizmit ka bërë që miliona njerëz ta shikojnë Biblën si të mbushur me fantazi dhe mit. Sipas tyre,

kristianizmi është i mirë vetëm për fëmijët; besimi shikohet si diçka që praktikohet vetëm nga njerëzit e pamend dhe premtimet biblike bëjnë mirë vetëm për psikologjinë. Me përhapjen e këtyre ideve ateistët i kanë privuar shpresën shumë njerëzve. Ateistët, duke i privuar vetes të drejtën e shpresës, kërkojnë të bëjnë të njëjtën gjë edhe me njerëzit e tjerë!

*E pesta, ateizmi shkakton një humbje të plotë të arsyes.* Ateizmi përpiqet të verifikojë ekzistencën e Perëndisë në një rrugë shkencore. Meqenëse nuk e vërteton dot Perëndinë me anë të të parit, të dëgjimit apo të të prekurit, ai beson se «arsyeja justifikon» mohimin e Perëndisë. Një «arsye» e tillë është e gabuar. Ateizmi thotë se Perëndia nuk ekziston, por ai nuk ofron ndonjë «justifikim të arsyeshem» për këtë pretendim! Një njeri mund të hidhet nga një ndërtesë e lartë dhe, gjatë rënies poshtë, mund të bërtasë se graviteti nuk ekziston, por në pak kohë fundi do të vijë dhe ai do të vuajë pasojat e një budallallëku të tillë. E njëjta gjë është e vërtetë me argumentin e ateizmit se nuk ka ndonjë evidencë «të arsyeshme» për ekzistencën e Perëndisë.

## **SI PËRGJIGJE, BESIMI NË PERËNDI SJELL SHPRESË TË MADHE!**

Boshësia çnjerëzore e ateizmit ka ndryshim të dukshëm me alternativën e besimit në Perëndi. Çfarë nuk ka ateizmi gjendet me bollëk në besimin se ekziston një Perëndi i madh! Dy fakte të paevitueshme mbështesin shpjegimin për pranimin e Perëndisë dhe për mohimin e ateizmit.

*E para, besimi në Perëndi na jep të vetmen «pikëpamje» të pranueshme për jetën.* «Pikëpamja» jonë për jetën influencon sjelljen, idetë, përvojat dhe qëllimet tona në jetë. «Pikëpamja» që kemi për jetën shpjegon gjithë vendimet dhe veprimet e jetës sonë. Çdo njeri udhëhiqet nga një pikëpamje për jetën (pavarësisht nëse ai e pranon këtë apo jo). Logjika na thotë se ne duhet të studiojmë çdo pikëpamje njerëzore dhe të zgjedhim atë që do të sjellë gëzimin dhe kënaqësinë më të madhe për jetën tokësore. Në ç' mënyrë zgjedhim një pikëpamje që do të sjellë gëzim dhe kënaqësi? Kriteret e mëposhtme ofrojnë një drejtim të përshtatshëm. (1) Shikoni për fakte mbështetëse që kundërshtojnë konkluzionet e gabuara dhe të pabazuara. Kjo do të thotë se faktet nuk janë të bazuara mbi ndonjë pikëpamje. (2) Sigurohuni se pikëpamja ka unitet apo harmoni në vetvete. E vërteta është gjithmonë

e pandryshueshme dhe e qëndrueshme. Një pikëpamje e vërtetë nuk mund të bazohet në ide që janë kontradiktore. (3) Shikoni për shpjegime të besueshme. Kur kjo pikëpamje e caktuar flet për jetën, shikoni se si i mbledh faktet, se si argumentat e saj krijojnë teorinë dhe se sa me ndershmëri ligjet e saj pëshkruajnë ndryshueshmërinë në sjellje. (4) Sigurohuni se pikëpamja nuk përmban ndonjë teori që është shumë e komplikuar apo shumë ekstreme. (5) Sigurohuni se ajo përmban më tepër se sa një rresht me prova. Provat duhet të vijnë nga burime të ndryshme dhe gjithë provat, vazhdimisht, duhet të kenë lidhje me teorinë e saj. (6) Ajo duhet të jetë në gjendje të refuzojë pikëpamjet kontradiktore. Uniteti i evidencës së saj duhet ta ndihmojë atë që të bazohet mbi të vërtetën dhe të ngrihet mbi gjithë pikëpamjet e tjera tokësore.

Kur ne i besojmë një pikëpamjeje të caktuar për jetën, atëherë ne jemi në gjendje të shpjegojmë jetën në tokë e të gjejmë kuptimin dhe qëllimin e saj. Mbani mend se çdo pikëpamje që kërkon duhet t'u përgjigjet tre pyetjeve: A është kjo pikëpamje logjiksht e qëndrueshme në ato që supozon? A bazohet ajo mbi të dhëna të sakta? A është e pranueshme dhe e dobishme për njeriun e sotëm?

Pasi këto pyetje u bëhen botëkuptimeve të mundshme, ne do të zbulojmë se vetëm besimi në Perëndi ofron botëkuptimin më të kënaqshëm për jetën. Ateizmi nuk është në gjendje që t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve! Pra, besimi në Perëndi ofron të vetmin botëkuptim logjik, të qëndrueshëm dhe sistematik.

*E dyta, besimi në Perëndi ofron filozofinë më të mirë që i duhet njeriut për jetën.* Çdo konkluzion arrihet pas përdorimit të metodës me tre hapa që në fillim kontrollon supozimet dhe më pas parashtron argumentat dhe më në fund nxjerr mësimet për jetën. Përdorimi i kësaj metode nxjerr në pah dobësitë e ateizmit dhe vlerën e madhe të besimit në Perëndi. Këto tre hapa bashkohen dhe formojnë një themel të fortë për Filozofinë e besimit në Perëndi.

Metoda fillon me logjikën që ofron një arsytim të vazhdueshëm. Qëllimi është që të kërkojë të Vërtetën dhe të mohosh gabimin. Ky hap i parë të ndihmon që të kuptosh se pse një fakt i caktuar besohet dhe pse duhet fuqizuar dhe ruajtur besimi që ke krijuar.

Pasi të jenë kuptuar këto fakte të vërteta, atëherë kjo metodë shikon përtej arsyes dhe përqëndrohet

në imagjinatën dhe ndjenjat (domethënë ka aftësinë për të «ëndërruar»). Përmes këtij hapi mendjet njerëzore janë në gjendje ta shikojnë me gëzim të ardhmen, sepse nevojat e tyre elementare janë plotësuar. Ekziston një rrezik në këtë hap të dytë, një individ mund të lejojë që ndjenjat e tij të kthehen kundër arsyes. Dhe, kur kjo ndodh, mendja njerëzore injoron faktet e vërteta dhe ndjek diçka jo të vërtetë. Shpesh ata që udhëhiqen nga ndjenjat dhe jo nga logjika bëjnë gjëra të pamoralshme apo bien pre e agonisë. Imagjinoni dy të rinj që e njohin shumë pak njëri-tjetrin (por e pëlqejnë shumë paraqitjen fizike të njëri-tjetrit) dhe mendojnë se midis tyre ekziston një dashuri e thellë dhe e fortë. Ata vendosin të martohen dhe kjo realizohet shumë shpejt. Por, vetëm pas disa muajsh, «dashuria» e madhe për flokët, sytë apo belin e bukur, kanë kaluar dhe zënkat e pakënaqësia kanë hyrë në mes tyre. Shumë shpejt të dy vendosin të prishin martesën. A nuk është kjo një tragjedi që sot e shikojmë kaq shpesh të ndodhë? Cili ishte shkaku i kësaj tragjedie? Si djali dhe vajza e dinin se ishte e rëndësishme të njihnin mirë personin me të cilin do të lidhnin jetën. Deri këtu jemi në rregull. Problemi fillon kur për të njohur njëri-tjetrin, ata u nisën nga ndjenjat e tyre, gjë që nuk i linte të shikonin të vërtetën ashtu siç ishte. Ata nuk ranë në dashuri me njëri-tjetrin, por me një iluzion të krijuar nga ndjenjat në mendjet e tyre. Ata nuk arritën ta njihnin me të vërtetë njëri-tjetrin. Po të ndjekësh faktet e vërteta, atëhere mendja njerëzore shpreson dhe udhëhiqet drejt asaj që është fisnike dhe e drejtë, me qëllim që ta bëjë botën një vend më të mirë për të jetuar. Është një fatkeqësi që shumë veta që besojnë në Perëndi nuk janë në gjendje të frenojnë tundimet e tyre, por i lënë ndjenjat të komandojnë faktet e vërteta. Kjo është po aq e rrezikshme sa mohimi që i bën një ateist Perëndisë, për arsye të emocioneve të tij. Një autor ka shkruar: «Njerëzit që nisen nga emocionet e tyre për të gjetur të vërtetën, gënjejnë veten.»

Pasi faktet pranohen dhe përforcohen nga emocionet, atëhere ndërmerret hapi i tretë, dhënia e shembujve apo modeleve për jetën e përditshme. Këtu shpjegohen «Pse»-të e jetës. Kjo është prova e realitetit. Kjo është pjesa ku opinionet tona morale vihen në provë, sepse veprimet tona do të gjykohen sipas besueshmërisë së dy hapave të para.

Besimi në Perëndi ofron filozofinë më të pranueshme për jetën tokësore, sepse është në gjendje të japë tre fakte thelbësore për njeriun e sotëm. E para, kjo filozofi ofron një model të arsyeshëm për jetën. Ky model i arsyeshëm mund të zbatohet në jetën tonë të përditshme. E dyta, parimet e tij mund të kalojnë nga një brez në tjetrin pa u ndryshuar. E treta, besimi në Perëndi është filozofia e vetme që i ofron njeriut argumente të qëndrueshëm në kërkimin e tij drejt së vërtetës, të cilën ai kërkoi ta zbulojë dhe të besojë në të. Me anë të shembujve, besimi në Perëndi i drejtohet imagjinatës së njeriut për ta ndihmuar të kuptojë të vërtetën, e cila është e rrënjësuar thellë në premtime të vërteta dhe më në fund e zbaton këtë të vërtetë në jetën e përditshme (sjelljen e njeriut) duke i urdhëruar të gjithë njerëzit të jetojnë sipas kësaj të vërtete. Kjo aftësi e besimit në Perëndi nxjerr në pah paaftësinë e ateizmit për të bërë të njëjtën gjë. Në qoftë se ateizmi përdor ndjenjat dhe emocionet për të udhëhequr jetën, atëherë ai ballafaqohet me kontradikta të shumta. Ateizmi nuk mund t' u drejtohet përvojave njerëzore si model për të jetuar, sepse përvojat njerëzore sjellin vetëm dilema dhe kontradikta. Ateizmi nuk mund të përdorë prova reale, sepse nuk ka ndonjë të tillë. Çdo gjë duhet filluar vetëm me të Vërtetën që mund të vërtetohet, provohet në jetë dhe përdoret. Filozofia ateiste nuk është aspak në gjendje të zbulojë dhe të bëjë të njohur «të vërtetën».

Lexoni 2 Mbretërve 5 dhe shikoni se si gjenerali sirian zbuloi besimin në Perëndi si të vetmen filozofi të praktikueshme në jetën e përditshme. Naamani kaloi nëpërmjet këtyre etapave themelore, kur por kërkonte një përgjigje për situatën e tij të pashpresë dhe boshe në jetë. Vëreni se si jeta e tij e ilustron këtë proces.

Kur erdhi në Izrael, ai besonte se të gjitha fetë ishin të mira. Ai në fakt ishte një ateist pragmatik, sepse ai nuk kishte një besim absolut të Perëndia por pranonte çdo «zot» përderisa ishte në anën e tij. Kur hyri në Izrael për të gjetur Eliseun, ai ishte i gatshëm që të pranonte «Perëndinë e tij» (të Eliseut, 2 Mbretërve 5:11). Pasi u shërua nga lebra, Naamani u bind se ekzistonte një Perëndi i vetëm (2 Mbretërve 5:15). Çfarë influençoi në këtë ndryshim të menjëhershëm në një kohë kaq të shkurtër? Qartësisht Naamani përdori procesin e arsyesimit të përshkruar më lart dhe arriti në përfundimin se ekzistonte vetëm një Perëndi. Kjo është e qartë nga faktet e

mëposhtme. Ai, përveç ndjenjave dhe emocioneve, zotëronte prova të besueshme për fuqinë e Perëndisë (vargjet 11 dhe 15). Më pas ai pa një vijueshmëri të fakteve të vërteta dhe kjo vijueshmëri s'mund të mohohej. Kur u bind, ai u pastrua (vargjet 13 dhe 14). Më tej, duke u bazuar në faktet dhe në përvojën e tij, ai krijoi një shpjegim i cili përshkruante një sjellje të veçantë (vargjet 15–17). Përpara se të zhvillonte besimin te Perëndia, Naamani u ballafaqua me boshësinë dhe pakuptueshmërinë e filozofisë ateiste. Pasi e ndryshoi pikëpamjen e tij për jetën, jeta e tij u bë e plotë dhe e kënaqshme. Ai tani mund të jetonte në «paqe» (v. 19), sepse ai kishte gjetur Perëndinë e vetëm dhe të vërtetë. Një ndryshim i njëjtë, nga një humbje e plotë në një fitore të madhe, është i mundshëm për të gjithë ata që me ndershmëri kërkojnë të vërtetën!

## REZULTATET DHE PASOJAT E KËTYRE ALTERNATIVAVE

Çështja e ateizmit dhe e besimit në Perëndi nuk është një çështje për t'u debatuar pafundësisht nga intelektualët. Kjo çështje influencon çdo qenie njerëzore. Qëllimi afatgjatë i këtyre mësimëve rreth ateizmit është që t'ju bëjë të mendoni rreth tre pasojave thelbësore të vendimit që çdo njeri merr nëse do t'i besojë Perëndisë apo jo.

E para, kur zgjedhim midis këtyre dy filozofive, ne zgjedhim midis dinjitetit tonë si njerëz dhe fatit tonë të përjetshëm! Ateizmi përmban pikëpamjen më të zymtë të njerëzimit. Besimi në Perëndi sjell shpresën e vetme për njerëzimin. Në këtë pikë, ateizmi duhet të ballafaqohet me padrejtësinë e madhe të filozofisë së tij.

E dyta, kur zgjedhim midis këtyre dy filozofive, ne vendosim ose të humbim në mënyrë të pariparueshme ose të fitojmë në mënyrë të pamagjinueshme. Ata që zgjedhin ateizmin nuk do të kenë ndonjë shpresë, kuptim apo qëllim në jetë. Si mundet që një mendje e arsyeshme të marrë një vendim të tillë?

E treta, kjo zgjedhje reflekton dëshirën ose mungesën e dëshirës nga ana jonë për të pranuar se kemi nevojë për Perëndinë. Ateisti shpesh e mohon Perëndinë jo nga arsyetimi i tij intelektual apo nga provat e vërteta, por nga arroganca e tij kokëforte. Historia e përshkruan këtë sjellje përmes poetëve

Romantikë. Si për ironi, shkrimet e tyre paraqesin zbrazëtinë e jetës që bëjnë. «Ozimandias» e Percy Bysshe Shelley (poet i shquar amerikan i shek. XX) paraqet kotësinë e arrogancës ateiste. Një njeri, jeta e të cilit po rrënohet, jepet me anë të këtyre fjalëve të ligështa në poemë:

«Emri im është Ozimandias, mbret i mbretërve:  
Shiko veprat e mia, o i Plotfuqishëm dhe dëshpërohu!»  
Asgjë nuk mbetet më tej. Përreth shpërbërjes së  
Asaj rrënoje të madhe, të pafund dhe të pamëshirshme,  
Rëra e pamatë dhe e niveluar shtrihet shumë larg.

Përshkrimi i Shelley-it rreth ateizmit arrogant është i vërtetë. Besimi apo mosbesimi në ekzistencën e Perëndisë tregon dëshirën apo mungesën e kësaj dëshire për t'u ndier i përulur dhe për të njohur fuqinë e Perëndisë.

## KONKLUZIONI

Pikëpamja që ka njeriu për jetën vendos për qëllimin dhe gëzimin e tij. E vetmja pikëpamje e arsyeshme për jetën në tokë është ajo që e konsideron atë si një periudhë përgatitjeje për jetën e përjetshme. Ky fakt bën që të shikojmë dhe të vlerësojmë veprat e Perëndisë këtu në tokë (Veprat 17:24–28). Kjo bën që të kuptojmë se Perëndia ekziston (Danieli 2:28). Ajo na tregon domosdoshmërinë që gjithë njerëzit ta shikojnë jetën e tyre sipas filozofisë së besimit në Perëndi. Një nevojë e tillë ilustron nga Nebukadnetsari arrogant, i cili më në fund ndryshoi pikëpamjen e tij për jetën, duke pranuar besimin në Perëndi (Danieli 2:47, 4:34–37).

Kur e shikojmë jetën në tokë duke vënë Perëndinë në qendër të saj, atëherë do të jemi në gjendje të dallojmë dhembshurinë e të Plotfuqishmit, dëshirën e Tij që të njihet nga njerëzit dhe gadishmërinë e Tij për të rigjallëruar njeriun mëkatar (Veprat 17:27; Gjoni 3:16). Sipas pikëpamjes kristiane, nuk është një rastësi fakti që në fillim Perëndia i mëshirshëm e krijoi njeriun të tillë që ai të kishte nevojë për praninë e Perëndisë dhe për aktivitetin e Tij të përditshëm në jetën e njeriut në kopshtin e Edenit. Gjithashtu nuk është e rastësishme që i njëjti Perëndi i mëshirshëm e mbylli librin e fundit të Biblës me të njëjtën dhembshuri, kur i bën thirrje njeriut «Eja» (Zbulesa 22:17).